

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Türk Hava Yolları Anonim Ortaklığı, Ndërtesa e Administratës së Përgjithshme, lagjja Yeşilköy, rr. Havaalanı nr. 3/1, 34149 Bakırköy, Stamboll, Turqi, dhe Globalia Corporación Empresarial S.A., Carretera Arenal–Llucmajor km. 21,5, Polígono Son Noguera, 07620 Majorca, Spanjë, i dorëzuar përmes Filip Zafirovskit, avokat nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 22.04.2026, mori këtë:

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin Türk Hava Yolları Anonim Ortaklığı, Ndërtesa e Administratës së Përgjithshme, lagjja Yeşilköy, rr. Havaalanı nr. 3/1, 34149 Bakırköy, Stamboll, Turqi, dhe Globalia Corporación Empresarial S.A., Carretera Arenal–Llucmajor km. 21,5, Polígono Son Noguera, 07620 Majorca, Spanjë, do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Air Europa Holding S.L., Carretera Arenal–Llucmajor km. 21,5, Polígono Son Noguera, 07620 Majorca, Spanjë, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi dhe programi i të ardhurave 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 17.03.2026, e plotësuar më 07.04.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), u dorëzua njoftim për përqendrim nga Türk Hava Yolları Anonim Ortaklığı, Ndërtesa e Administratës së Përgjithshme, lagjja Yeşilköy, rr. Havaalanı nr. 3/1, 34149 Bakırköy, Stamboll, Turqi, dhe Globalia Corporación Empresarial S.A., Carretera Arenal–Llucmajor km. 21,5, Polígono Son Noguera, 07620 Majorca, Spanjë, me të cilin Türk Hava Yolları Anonim Ortaklığı dhe Globalia Corporación Empresarial S.A. do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Air Europa Holding S.L., Carretera Arenal–Llucmajor km. 21,5, Polígono Son Noguera, 07620 Majorca, Spanjë, dhe në mënyrë indirekte mbi shoqëritë e saj të varura në pronësi të plotë: Air Europa Líneas Aéreas S.A., Air Europa Suma

Miles S.L.U., Aeronova S.L.U., León Activos Aeronáuticos S.L.U. dhe Globalia Activos Inmobiliarios S.A.U., përmes shitblerjes së pjesëve.

Aktualisht, Air Europa Holding S.L. kontrollohet ekskluzivisht nga Globalia Corporación Empresarial S.A., e cila kontrollohet përfundimisht nga JJH Capital & Asset Management, S.L.

Pas transaksionit, Air Europa Holding S.L. do të kontrollohet së bashku nga Türk Hava Yolları Anonim Ortaklığı dhe Globalia Corporación Empresarial S.A., ndërsa International Consolidated Airlines Group, S.A. do ta ruajë pjesën e saj jo kontrolluese në Shoqërinë e synuar.

Komisioni filloi shqyrtimin e njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe, në bazë të të dhënave të paraqitura në njoftimin për përqendrim dhe dokumentacionit të bashkëngjitur, konstatoi sa vijon:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira

Türk Hava Yolları Anonim Ortaklığı është shoqëria mëmë e Grupit Turkish Airlines. Ajo është një shoqëri aksionare e listuar publikisht, e themeluar në Turqi, dhe shërben si transportuesi kombëtar i vendit. E themeluar në vitin 1933, shoqëria është zhvilluar në një nga kompanitë ajrore kryesore në botë, duke ofruar transport të rregullt të udhëtarëve në më shumë se 130 shtete nga qendra e saj në Stamboll – një nga qendrat kryesore botërore të aviacionit. Me një flotë prej më shumë se 500 avionësh me trup të ngushtë dhe të gjerë, Grupi Turkish Airlines ofron shërbime të transportit të udhëtarëve dhe mallrave në mbi 350 destinacione në mbarë botën dhe realizon operacione globale të transportit ajror të mallrave nën markën Turkish Cargo, përmes një rrjeti të gjerë logjistik. Përmes shoqërive të saj të varura, Türk Hava Yolları Anonim Ortaklığı vepron si një grup i integruar i aviacionit, që përfshin transportin e udhëtarëve, logjistikën e mallrave, shërbimet teknike, shërbimet tokësore, hotelerinë, teknologjinë dhe sistemet e pagesave.

Türk Hava Yolları Anonim Ortaklığı është gjithashtu anëtare e Star Alliance.

Grupi Turkish Airlines ka një përfaqësi në Republikën e Maqedonisë së Veriut me emrin TURKISH AIRLINES Istanbul R. Turqi – Përfaqësi Shkup, me seli të regjistruar në Bulevardin Kliment Ohridski nr. 23, Shkup.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi Turkish Airlines ushtron veprimtari të transportit ajror të udhëtarëve dhe mallrave, me fluturime të rregullta dhe çarter nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Shkupit dhe Aeroportit Shën Apostull Pavli në Ohër, nga dhe drejt Turqisë dhe, vetëm në mënyrë indirekte, drejt destinacioneve të tjera ndërkombëtare.

Globalia Corporación Empresarial S.A. është një grup turistik spanjoll që kryesisht vepron në fushën e transportit ajror të udhëtarëve dhe mallrave, aktiviteteve ndihmëse të lidhura me to, shërbimeve tokësore, mirëmbajtjes, riparimit dhe remontit, si dhe shërbimeve të menaxhimit të hoteleve.

Globalia Corporación Empresarial S.A. nuk ka shoqëri të varura, filiale apo përfaqësi të themeluara në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizon qarkullim në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Air Europa Holding S.L. është një grup spanjoll i aviacionit që kryesisht operon shërbime ajrore të rregullta ndërkombëtare dhe vendore për transportin e udhëtarëve dhe mallrave.

Ai gjithashtu ofron shërbime ndihmëse dhe detyësore të lidhura me këtë veprimtari, si menaxhimi i fluturimeve charter, dhënia me qira e avionëve me ekuipazh, mirëmbajtje dhe sigurim (ang. wet leasing), si dhe mirëmbajtje të linjave ajrore.

Air Europa Holding S.L. nuk është e pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizon qarkullim në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) të Ligjit

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ